34.377

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
Nr. 34377 Vendimi

**VENDIM**

**"Per Regjistrimin si Person Juridik"**

Sot me dt 16/11/ 2005, une Gjyqtarja e Gjykates se Rrethit GjyqesorTirane A. Kurkus pasi mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga

KERKUESI: **PERPARIM TAULLAI**,biri i Aliut, dtl.01.06.1948, lindur e banues ne Durres, L. Nr.1, Rr."Taulantia", Nr.986

Me OBJEKT : Regjistrimi si person juridik te shoqerise "IRI - TRANS"SHPK"

KONSTATOVA:

Sic rezulton nga Akti i themelimit Nr.1127/108 dhe Statuti Nr.1129/109, dt.14.11.2005, kerkuesi Perparim Taullai si Ortak i Vetem ka themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emrin "IRI - TRANS"SHPK", me seli ne Lagjen Nr.14, Rruga "Asti Gogoli"", Shkozet-Durres, me kohezgja-tje te aktivitetit per nje periudhe kohe te pakufizuar, e cila ka si objekt te veprimtarise se saj:

- Ne fushen e Transporteve :

Transport udhetaresh Urban, Nderurban dhe Interurban me mjetet e veta apo te te treteve. Agjensi Transporti dhe Udhetaresh.

- Ne fushen e Tregetise :

Tregetimi, Import-Eksport me shumice e pakice i automjeteve te transportit per mallra dhe udhetare, te gjitha llojeve dhe tonazheve, pjese kembimi per to, Servis e Lavazh per automjete, mallra ushqimore, industriale, bujqesore e blegtorale, veshembathje, kepuce, hidrosanitare, paisje elektrike dhe elektronike, elektroshtepiake, material ndertimi lende te para per industrine, kancelari, mobilje, orendi shtepiake, paisje zyrash, kimikate per bujqesine .

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Kuota ne perqindje e ortakut te vetem ne kete shoqeri eshte 100 % . Aministrator i shoqerise eshte ortaku i vetem **Z.Perparim Taullai** ..

Kerkeses i kam bashkalidhur edhe Aktin e themelimit dhe Statutin i legalizuar nga noterja Gentjana Bardhoka, si dhe vertetimin e Deges se Bankes Kombetare Tregtare qe konfirmon derdhjen e kapitalit themeltar te shoqerise..

Kerkuesi ka paraqitur per depozitim Aktin e themelimit Nr.1127/108 dhe Statutin Nr.1129/109, dt.14.11.2005, si dhe vertetimin e Deges se Bankes Kombetare Tregtare qe konfirmon derdhjen e kapitalit themeltar te shoqerise..

Cmohet se kerkesa eshte e bazuar dhe duhet te pranohet plotesisht

PER KETO ARESYE :

Gjykata ne baze te ligjit Nr.7638, dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

VENDOSI :

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin : **"IRI - TRANS"**shpk, me seli ne Lagjen Nr.14, Rruga "Asti Gogoli"", Shkozet-Durres, me kohezgjatje te aktivitetit per nje periudhe kohe te pakufizuar, me kapital themeltar 100.000 leke, me **Ortak te Vetem-Administrator**

**<u>Z.Perparim Taullai</u>** me kuote 100 %, e cila ka si objekt te veprimtarise se saj:

- <u>Ne fushen e Transporteve</u> :

Transport udhetaresh Urban, Nderurban dhe Interurban me mjetet e veta apo te te treteve. Agjensi Transporti dhe Udhetaresh.

- <u>Ne fushen e Tregetise :</u>

Tregetimi, Import-Eksport me shumice e pakice i automjeteve te transportit per mallra dhe udhetare, te te gjitha llojeve dhe tonazheve, pjese kembimi per to, Servis e Lavazh per automjete, mallra ushqimore, industriale, bujqesore e blegtorale, veshembathje, kepuce, hidrosanitare, paisje elektrike dhe elektronike, elektroshtepiake, material ndertimi lende te para per industrine, kancelari, mobilje, orendi shtepiake, paisje zyrash, kimikate per bujqesine .

Kunder vendimit lejohet ankim ne shkalle te dyte

GJYQTARE..

Altina Klemosha



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE**
**NR ..34377/1..Vendimit**

**VENDIM**
**I GJYQTARIT TE VETEM**

Ne Tirane sot me date 19 / 09 /2006,une gjyqtarja ______________ e rrethit gjyqesor Tirane pasi u njoha me materialet e paraqitura nga:

**KERKUESI:** Ortaku i vetem dhe Administratori i shoqerise **"IRI-TRANS"** SH.P.K. Durres Z. Perparim TAULLAI i biri i Ali lindur ne Durres me 01.06.1948, dhe banues ne Durres.

**K O N S T A T O V A:**

Me Vendimin Nr. 34377 date 16.11.2005 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "IRI-TRANS"sh.p.k.

Po keshtu me Vendimin nr.1 date 08.09.2006 te Ortakut te Vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar " IRI-TRANS" shpk z. Perparim Taullai eshte vendosur qe te shiten kuotat e kapitalit ne masen 10 % te kesaj shoqerie ne shumen 10.000 ( pesedhjete mije ) lek, z. Rudin Taullai se bashku me te gjitha te drejtat dhe detyrimet mbi kete shoqeri. Me kontraten e shitjes nr. 1955 Rep, nr. 582/1 Kol date 08.09.2006, te noteres Ines V.ALEKSI, **i jane shitur nga z. Rudin Taullai ne masen 10 % kuotat e kapitalit ne shumen 10.000 (dhjete mije ) lek te shoqerise " IRI-TRANS" shpk.**

**Gjithashtu po me kete vendim eshte vendosur te shtohet veprimatria e shoqerise me aktivitetin: BAR-RESTORANT**

Meqenese kerkesa e bere dhe dokumentat e paraqitura i plotesojne te gjitha kushtet ligjore .

**PER KETO ARESYE :**

Ne baze te ligjit nr.7638 dt 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare" si dhe ne baze te ligjit nr. 7657 date 28.01.1993 "Per Rregjistrimin ne Rregjistrin Tregtar"

**V E N D O S A:**

Te urdheroj zyren e Regjistrit Tregtar per te depozituar Vendimin Nr.1 date 08.09.2006 te Ortakut te Vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "IRI-TRANS" sh.p.k. duke bere :

- Ndryshimin e perqindjes se kuotes te ortakut te vetem ne masen 90% i perkasin Z.Perparim Taullai dhe 10% i perkasin Z. Rudin Taullai duke u bere te dy ortake te shoqerise "IRI-TRANS"
- Shtese te objektit te shoqerise me aktivitetin: BAR-RESTORANT

-Te ndahen regjistrimet nga njeri- tjetri me vije te kuqe dhe te behen shenimet perkatese ne kollonen .................. reshtin .........

Tirane ,me 19.09. 2006

**GJYQTARE**

## AKT-THEMELIMI

## I

## SHOQERISE "IRI - TRANS" SHPK

Me ane te ketij dokumenti, te redaktuar ne 5 (pese) kopje origjinale dy per ortakun e vetem, nje Zyren Noteriale, nje per Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe nje per Zyren e Tatim Taksave,

**ORTAKU I VETEM** : **PERPARIM TAULLAI,** biri i Aliut, dtl.01.06.1948, lindur e banues ne Durres, L. Nr.1, Rr."Taulantia", Nr.986, mbajtes i pasaportes Nr.Z0042116, ra dakort per sa me poshte vijon :

1. Te themeloje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin:"IRI - TRANS"SHPK

2. "IRI - TRANS" SHPK eshte person juridik shqiptar dhe si e tille do te filloje aktivitetin tregetar, pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe organeve tatimore.

Aktivitetit I saj do te zhvillohet sipas ketij Akt-Themelimi, Statutit bashkalidhur dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

3. Kohezgjatja e aktivitetit te shoqerise fiksohet per nje periudhe kohe te pakufizuar...

4. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj :

- Ne fushen e Transporteve :

Transport udhetaresh Urban, Nderurban dhe Interurban me mjetet e veta apo te te treteve. Agjensi Transporti dhe Udhetaresh.

- Ne fushen e Tregetise :

Tregetimi, Import-Eksport me shumice e pakice i automjeteve te transportit per mallra dhe udhetare, te te gjitha llojeve dhe tonazheve, pjese kembimi per to, Servis e Lavazh per automjete, mallra ushqimore, industriale, bujqesore e blegtorale, veshembathje, kepuce, hidrosanitare, paisje elektrike dhe elektronike, elektroshtepiake, material ndertimi lende te para per industrine, kancelari, mobilje, orendi shtepiake, paisje zyrash, kimikate per bujqesine .

5. Shoqeria mund te hape dhe te mbaje llogari rrjedhese ne leke apo valuata te tjera, prane bankave shqiptare apo te huaja, duke mundur gjithashtu te disponoje lirisht mjetet monetare te akumuluara ne to, konform legjislacionit ne fuqi...

6. Selia e shoqerise eshte ne adresen: Lagja Nr.14, Rruga "Asti Gogoli"", Shkozet-Durres. Asambleja ka kompetencen te hape filiale e agjensi te tjera dhe t'i mbylle ato, nese e quan te nevojshme

7. Kapitali themeltar i shoqerise perbehet vetem nga kontribute ne para dhe eshte 100.000 (njeqindmije) leke shqiptare.

Ky kapital eshte i ndare ne 100 (njeqind) pjese me vlere nominative 1.000 (njemije) leke secila.

Kuota ne % e ortakut te vetem ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte 100 % (njeqindperqind) ..

Kapitali themeltar eshte depozituar prane Deges se Bankes Tregetare Kombetare Durres..

8. Administrimi dhe perfaqesimi i shoqerise do te behet nga ortaku i vetem **Perparim Taullai**, i cili eshte njekohesisht edhe **ADMINISTRATOR** i shoqerise..

Administratori eshte emeruar per nje periudhe kohe te pacaktuar dhe ka te drejten e firmes dhe te perfaqesimit te shoqerise..

Administratori gezon kompetenca te pakufizuara per realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise.Ne permbushjen e detyres se tij, mund te vere ne levizje instanca juridike dhe administrative, duke emeruar avokate e duke leshuar prokura ne raste gjyqesh, kryerjen operacione bankare, perfshire ketu hapjen e llogarive rrjedhese, neneshkrimin dhe xhirimin e ceqeve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo me U/Xhirimi e tituj krediti, paradhenie e kredi etj ..

9. Viti ekonomik fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti. Viti i pare ekonomik, mbyllet me di 31 Dhjetor 2005..

10. Ne nje liber te posacem te shoqerise shenohet kapitali themeltar, vlera e kontributit dhe kuota e ortakut te vetem ..

Ne perfundim te vitit ekonomik, pas aprovimit te bilancit, Asamblea pasi ka ndare fonde per likuidimin e detyrimeve ndaj te treteve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rezervat e detyrueshme, vendos per ndarjen e fitimit neto.. Per humbjet pergjigjet eskluzivisht shoqeria me kapitalin e saj..

11. Ortaku i vetem mund ta zmadhoj kontributin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise, duke depozituar fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqerise, konforme rregullave te parashikuara ne Statutin e shoqerise.

12. Ortaku i Vetem dhe Administratoret ( nese do te emerohen te tille) jane te detyruar te ruajne sekretin mbi dokumentacionin dhe te dhenat, njohurite dhe eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqerise, dhe marrin te gjitha masat e nevojshme te sigurise per te evituar perhapjen, qofte edhe pjeserisht.... .

Ata jane pergjegjes per pasojat negative qe mund te vijne nga shkelja e dispozites se mesiperme....Sa siper vlen edhe per edhe per Ekspertin Kontabel te Miratuar..

Ortaku i Vetem eshte pergjegjes, ndaj te treteve per demet qe mund t'u shkaktohen nga anullimi apo deklarimi i pavlefshem i ketij akti themelues.

Per sa nuk specifikohet shprehimisht ne kete akt, vlejne normat e Statutit bashkangjitur..

Paralelisht me nenshkrimin e ketij akti, ortaku i vetem neneshkruan edhe Statutin e shoqerise "IRI - TRANS" SHPK, i cili i bashkalidhet aktit te themelimit dhe eshte pjese perberese e tij..

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "IRI - TRANS" SHPK

# S T A T U T I
# I
## SHOQERISE "IRI - TRANS" SHPK

### KREU I
### DISPOZITA TE PERGJITHESHME
**Neni 1**

Me kete Statut te te njejtes date te redaktuar ne 5 (pese) kopje origjinale dy per ortakun e vetem, nje Zyren Noteriale, nje per Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Tirane dhe nje per Zyren e Tatim Taksave) :

**ORTAKU I VETEM** : **PERPARIM TAULLAI,** biri i Aliut, dtl.01.06.1948, lindur e banues ne Durres, L.Nr.1,Rr."Taulantia",Nr.986, mbajtes i pasaportes Nr.Z0042116, i cili ra dakort per sa me poshte vijon :

**Neni 2**

Te themeloje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me emertimin:"IRI - TRANS"SHPK", person juridik shqiptar, i cila do te filloje aktivitetin tregetar, pas regjistrimit ne Regjistrin Tregtar prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane dhe organeve tatimore.

Aktivitetit I saj do te zhvillohet sipas ketij Statuti, Akt-Themelimit bashkalidhur dhe legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**Neni 3**

Kohezgjatja e aktivitetit fiksohet per nje periudhe kohe te pakufizuar...

**Neni 4**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj :

- Ne fushen e Transporteve :

Transport udhetaresh Urban, Nderurban dhe Interurban me mjetet e veta apo te te treteve. Agjensi Transporti dhe Udhetaresh.

- Ne fushen e Tregetise :

Tregetimi, Import-Eksport me shumice e pakice i automjeteve te transportit per mallra dhe udhetare, te te gjitha llojeve dhe tonazheve, pjese kembimi per to, Servis e Lavazh per automjete, mallra ushqimore, industriale, bujqesore e blegtorale, veshembathje, kepuce, hidrosanitare, paisje elektrike dhe elektronike, elektroshtepiake, material ndertimi lende te para per industrine, kancelari, mobilje, orendi shtepiake, paisje zyrash, kimikate per bujqesine .

**Neni 5**

Vula e shoqerise ka mbishkrimin: "IRI - TRANS" SHPK

**Neni 6**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Lagja Nr.14, Rruga "Asti Gogoli", Shkozet-Durres.
Asambleja ka kompetencen te hape filiale e agjensi te tjera dhe t'i mbylle ato, nese e quan te nevojshme

### KREU II
### KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTA
**Neni 7**

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet vetem nga kontribute ne para dhe eshte 100.000

(njeqindmije) leke shqiptare.

Ky kapital eshte i ndare ne 100 (njeqind) pjese, sejcila me vlere nominative 1.000 (njemije) leke.

Kuotat ne % e ortakut te vetem ne kapitalin themeltar te shoqerise eshte 100 % (njeqind-perqind)..

Kapitali themeltar eshte depozituar prane Deges se Bankes Tregetare Kombetare Durres..

## KREU III
## TRANSFERIMI I PJESEVE NOMINATIVE TE KAPITALIT THEMELTAR

### Neni 8

* Pjeset nominative te kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme.

* Transferimi i pjeseve nominative te kapitalit themeltar, behet me miratimin e ortakut te vetem..

## KREU IV
## ASAMBLEJA

### Neni 9

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor i shoqerise, qe perfaqesohet nga Ortaku i vetem **PERPARIM TAULLAI**.

Vendimet e saj merren konform legjislacionit ne fuqi dhe ketij Statuti. Ato protokollohen ne regjister te vecante konform ligjit..

Asambleja ka te drejte te ushtroje ne cdo moment verifikime mbi administrimin dhe te kontrolloje cdo dokument te shoqerise. Ajo mund te urdheroje apo te udhezoje adminstratorin ( nese do te emerohen te tille) ne kryerjen e detyres se tij.

### Neni 10

Asambleja vendos per aprovimin e bilancit, ndarjen e fitimeve te mundshme, ndarjen e rezervave ligjore dhe vullnetare, emerimin dhe shkarkimin e administratoreve dhe te ekspertit kontabel te autorizuar, shperblimin e tyre, ndryshimin e selise se shoqerise (brenda territorit shqiptar), transferimin e kuotave, zmadhimin apo zvoglimin e kapitalit themeltar, zgjerimin e objektit te veprimtarise, transformimin e shoqerise, ndryshimet ne Statut, per masa ndaj administratorit, likuidimin e parakohshem apo kerkesen e falimentimit te shoqerise.

Asambleja mund te mblidhet edhe jashte selise se shoqerise, por gjithmone brenda teritorit shqiptar..

Kur Ortaku i vetem - Administrator vlereson se rrethana te vecanta e bejne te nevojshme, asambleja mund te thirret 6 muaj para mbylljes se ushtrimit te vitit financiar..

### Neni 11

Zmadhimi i kapitalit themeltar vendoset nga asambleja e ortakeve (ortaku i vetem). Pas vendimit te asamblese per zmadhimin e kapitalit, ortaku i vetem brenda 30 diteve duhet te beje derdhjet respektive te kapitalit qe zmadhohet..

### Neni 12

Zvoglimi i kapitalit vendoset nga asambleja e ortakeve (ortaku i vetem).. Kur si rezultat I humbjeve nga aktiviteti, kapitali bie nen vleren minimale te parashikuar nga Kodi Tregtar Shqiptar per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar dhe kur ortaku i vetem me ane kontributesh te reja ploteson kapitalin themeltar te shoqerise duhet te vendoset gjithashtu:
1.Ndryshimi i tipit te shoqerise;
2.Ndryshimi i Statutit;

3.Publikimi dhe njoftimi i te treteve me te cilet shoqeria ka mardhenie kontraktore si dhe kreditoret

Kur vendimi i zvoglimit te kapitalit nuk motivohet nga humbjet ne aktive, kreditoret e shoqerise duhen njoftuar menjehere.Ata mund te kundershtojne vendimin e zgoglimit ne rruge gjyqesore.

**Neni 13**

Transformimi i shoqerise ne shoqeri anonime, behet vetem pasi per dy vjet me rradhe asambleja te kete aprovuar bilancin e paraqitur nga administratori dhe nje ekspert kontabel i autorizuar te kete hartuar nje relacion mbi gjendjen e shoqerise..

Eshte i pavlefshem cdo transformim i shoqerise ne kundershtim me kete dispozite.

ADMINISTRIMI

**Neni 14**

Administrimi dhe perfaqesimi i shoqerise do te behet nga **Ortaku i Vetem Perparim Taullai** me gjeneralitetet e pershkruara ne Statut.. Administratori eshte emeruar per nje periudhe kohe te pacaktuar.. Ai ka ka te drejten e firmes dhe te perfaqesimit te shoqerise. Asambleja e Ortakeve ka te drejte te emeroje edhe Administratore te tjere qe mund edhe te mos jete ortake..

Administratori gezon kompetenca te pakufizuara per realizimin e objektit te veprimtarise se shoqerise. Ne permbushje te detyres se tij mund te vere ne levizje instanca juridike dhe administrative, duke emeruar avokate e duke leshuar prokura ne raste gjyqesh, te kryeje operacione bankare, perfshire ketu edhe hapjen e llogarive rrjedhese, nenshkrimin dhe xhirimin e ceqeve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve me leke ne dore apo urdher-xhirimi, tituj krediti, paradhenie krediti.

Administratori ne perfundim te cdo viti ekonomik perpilon nje relacion mbi aktivitetin e zhvilluar, objektivat e arritura dhe perspektiven e shoqerise, si dhe pergatit bilancin perfundimtar qe ia paraqet cdo vit Asamblese per aprovim.

Viti ekonomik fillon me 01 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te cdo viti.

**Neni 15**

Administratori mund te emeroje perfaqesues, te cileve individualisht apo kolektivisht, mund t'u jape te drejten e firmes, si dhe ato kompetenca, shperblime e garanci qe do te vlereshen te arsyeshme.

**Neni 16**

Administratori eshte pergjegjes individualisht ose solidarisht, sipas rastit, ndaj shoqerise ose te treteve, per shkeljet ligjore te Statutit apo faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Shoqeria nuk eshte pergjegjese ndaj te treteve, per aktivitete te kryera nga administratori ne kundershtim me kompetencat e tij, kur verteton se ata ishin ne dijeni te kesaj rrethane ..

Administratori pergjigjet personalisht para shoqerise dhe/ose te treteve qe kane pesuar deme nga ndonje veprim i tij i paligjshem..

**Neni 17**

Administratori mund te shkarkohet me vendim te asamblese ose nga gjykata, vetem me nje motivacion.. Ne mungese te nje motivacioni, pergjegjesit per shkarkimin e tij jane te detyruar te shper-blejne demet e shkaktuara ..

EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR

**Neni 18**

Emerimi i ekspertit kontabel te autorizuar behet me vendim te asamblese se ortakeve.

* Emerimi i ekspertit kontabel te autorizuar eshte i detyrueshem kur ne mbyllje te vitit financiar tejkalohen dy nga tre treguesit e meposhtem:

1.Totali i bilancit ne mbyllje te vitit perkates: 6.000.000 (gjashtemiljon) leke;
2.Totali i te ardhurave vjetore: 12.000.000(dymbedhjetemiljon)leke;
3.Numri mesatar i te punesuarve: 10 (dhjete)vete.

Kur ligji e parashikon shprehimisht prezencen e ekspertit kontabel te autorizuar, jane te pavlefshme operacionet e kryera pa prezencen e tij, ose ato ne prezence te nje eksperti te emeruar ne kundershtim me rregullat e parashikuara nga Nenet 168 dhe 169 te Ligjit Nr.7638,dt.19.11.92 "Per shoqerite tregtare".

Eksperti kontabel i autorizuar emrohet per nje periudhe prej 6(gjashte) vitesh financiare, pervec rasteve te shkarkimit te vendosura nga asambleja e ortakeve apo gjykata...

**Neni 19**

Eksperti Kontabel i autorizuar pasi ka verifikuar librat kontabel, arken dhe depozitat bankare, garanton qe kontabiliteti vjetor eshte mbajtur ne rregull, i korespondon te vertetes dhe eshte konforme legjislacionit ne fuqi.

Eksperti Kontabel i autorizuar perpilon dhe i paraqet Asamblese nje raport financiar mbi ushtrimin vjetor qe pasqyron situaten financiare ne nisje dhe ate ne mbyllje.

Kontrollon qe bilanci perfundimtar dhe Raporti i perpiluar nga Administratori per Asamblene, t'i korespondoje realitetit...

Eshte i detyruar ti paraqese Administratorit dhe asamblese se ortakeve:

a) Kontrollet, verifikimet dhe sondazhet e bera ;

b) Zerat e bilancit dhe dokumentacionin kontabel qe duhet korigjuar, duke sygjeruar edhe zgjidhjet;

c) Gabimet dhe pasaktesite e konstatuara ;

d) Rezultatin financiar pas korigjimeve te bera;

Ai duhet te thirret ne te gjitha mbledhjet e asamblese se ortakeve ku aprovohet bilanci i aktivitetit vjetor, por mund te thirret ne te gjitha rastet kur konsiderohet e nevojshme...

**Neni 20**

Eksperti kontabel i autorizuar pergjigjet ndaj shoqerise dhe ndaj te treteve per pasojat negative qe rrjedhin nga gabime e neglizhime ne kryerjen e funksionit te tij. Nuk mban pergjegjesi per shkeljet ligjore te kryera nga administratori, me perjashtim te rasteve kur ka pasur dijeni per to, por nuk i kane paraqitur dhe raportuar asamblese.

## KREU IV
## FITIMI DHE REZERVAT

**Neni 21**

Asambleja qe aprovon Bilancin duhet te destinoje 1/20 e fitimit vjetor te realizuar. per nje fond te emeruar "Rezerve e domosdoshme".

Dispozita e mesiperme nuk eshte e detyrueshme kur "Rezerva e domosdoshme"arrin 1/10 e kapitalit themeltar.

**Neni 22**

Fitimi qe do te shperndahet perbehet nga diferenca midis fitimit neto te realizuar gjate vitit financiar te sapombyllur dhe vleres se depozituar si "Rezerve e domosdoshme" konform Nenit 21 te Statutit..

Asambleja mund te vendose per formimin e fondeve te tjera si dhe mund te vendose per shperndarjen e ketyre fondeve, me kusht qe kjo shperndarje te mos sjelle zvoglimin e kapitalit ne limitin e parashikuar nga Kodi Tregtar Shqiptar dhe nga ky statut si dhe te mos preke "Rezerven e domosdoshme" ne masen e parashikuar ne Nenin 21..

**Neni 23**

Asambleja pasi ka miratuar bilancin perfundimtar dhe ka vendosur shumen qe do te shperndahet, percakton pjesen e fitimit qe i takon ortakut te vetem.

Gjate vitit, shoqeria ka te drejte t'i jape ortakut paradhenie mbi dividentet ne vlera jo me te medha se dividenti i shperndare nje vit me pare, me kusht qe:

a) Te mos preket "Rezerva e domosdoshme";

b) Te mbetet e depozituar nje rezerve, e barabarte me paradheniet qe do te shperndahen;

c) Eksperti kontabel i autorizuar te vertetoje ne nje relacion me shkrim qe fitimet neto te realizuara deri ne ate moment jane me te medha se paradheniet qe parashikohen per tu shperndare ortakut.

Shperndarja e paradhenieve vendoset nga asambleja ose administratori. Ne vendimin perkates duhet te specifikohen shumat dhe datat e kthimit.

Dividentet qe nuk korespondojne me fitimet e realizuara realisht, mund t'u reklamohen ortakeve qe i kane marre ato.

KREU V

PAVLEFSHMERIA, PRISHJA DHE LIKUJDIMI

**Neni 24**

Akti Themelues, Statuti si dhe aktet e tjera te shoqerise mund te konsiderohen te pavlefshem, vetem ne rast se shkelen dispozitat e parashikuara nga Ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 ose nga Kodi Civil.

**Neni 25**

Asambleja mund te vendose prishjen para afatit te shoqerise vetem kur :

Merret vendim nga Ortaku i Vetem qe perfaqeson te gjithe kapitalin themeltar. Humbet me shume se 1/2 se kapitalit themeltar dhe kur ky i fundit bie nen limitin e parashikuar per SHPK-te ne Kodin Tregtar.

Merret vendim nga Gjykata kompetente per fillimin e procedures se falimentimit.

LIKUIDIMI

**Neni 26**

Kur me vendim gjykate shpallet pavlefshmeria absolute apo relative e shoqerise si dhe ne rastet e parashikuara ne statut, asambleja e ortakeve vendos prishjen e parakoheshme te shoqerise dhe fillojne procedurat e likuidimit qe do te kryhen sipas kerkesave te parashikuara ne Kodin Tregtar Shqiptar dhe ne pergjithesi legjislacioni shqiptar ne fuqi .

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE "IRI - TRANS" SHPK

/ [signature] /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
Nr. 1128 Rep.Nr. 109 Kol.

VERTETIM

Ne Durres, sot me dt.14.11.2005, para meje, Noteres Ines Aleksi u paraqit Zoti Perparim Taulla, me gjeneralitet e pershkruara me siper, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, per identitetet e te cilit u sigurova me pasaporten personale Nr.Z0042116, i cili deklaroi se Statutin e mesiperm e kupton dhe e pranon pasi pasqyron vullnetin e tij te lire dhe me pas e nenshkroi ate rregullisht ne pranine time..Per sa siper une noterja vertetoj....

NOTERE

/ INES ALEKSI /

PULLE TAKSE

34377

KERKKESE

15 NENTOR 2005

:UESI: **PERPARIM TAULLAI,** biri i Aliut,dtl.01.06.1948, lindur e banues ne Durres, L. Nr.1, Rr."Taulantia", Nr.986

3JEKT : Regjistrimi si person juridik te shoqerise "IRI - TRANS"SHPK"

iore : Ligji Nr.7638, dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Sic rezulton nga Akti i themelimit dt.14.11.2005, i legalizuar nga noterja Ines Aleksi, une :s: Perparim Taullai si Ortak i Vetem, kam themeluar shoqerine me pergjegjesi te kufizuar me "IRI-TRANS" SHPK", me seli ne Lagjen Nr.14, Rruga "Asti Gogoli"", Shkozet-Durres, me gjatje te aktivitetit per nje periudhe kohe te pakufizuar, e cila ka si objekt te veprimtarise se saj.

Ne fushen e Transporteve :

port udhetaresh Urban, Nderurban dhe Interurban me mjetet e veta apo te te treteve. Agjensi porti dhe Udhetaresh.

Ne fushen e Tregetise :

irni, Import-Eksport me shumice e pakice i automjeteve te transportit per mallra dhe udhetare, te ;a llojeve dhe tonazheve, pjese kembimi per to, Servis e Lavazh per automjete, mallra ushqi- industriale, bujqesore e blegtorale, veshembathje, kepuce, hidrosanitare, paisje elektrike dhe ele- te, elektroshtepiake, material ndertimi lende te para per industrine, kancelari, mobilje, orendi ike, paisje zyrash, kimikate per bujqesine .

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke. Kuota ne perqindje e ortakut te vetem ne kete i eshte 100 % . Aministrator i shoqerise jam une ortaku i vetem **Z.Perparim Taullai**.

Kerkeses i kam bashkalidhur edhe Aktin e themelimit dhe Statutin i legalizuar nga noterja INES SI, si dhe vertetimin e Deges se Bankes Kombetare Tregtare qe konfirmon derdhjen e kapitalit tar te shoqerise..

Per sa me siper perfundimisht ne baze te Ligjit Nr.7638, dt.19.11.1992 "Per shoqerite tregtare"

KERKOJ:

Regjistrimi si person juridik te shoqerise "IRI - TRANS"SHPK"

KERKUESI

BLIKA E SHQIPERISE
IA E NOTEREVE DURRES
9 Rep.Nr. 110 Kol.

VERTETIM

res, sot me dt.14.11.2005, para meje, Noteres Ines Aleksi u paraqit Z.Perparim Taullai, me liret e pershkruara me siper, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, per identitetet e u sigurova me pasaporten personale Nr.Z0042116, i cili deklaroi se Kerkesen e mesiperme e dhe e pranon pasi pasqyron vullnetin e tij te lire dhe me pas e nenshkroi ate rregullisht ne prani je....Per sa siper une noterja vertetoj....

NOTERE

INES ALEKSI

30377 /1

12.09.2006

12 SHTATOR 2006

# KERKESE

**KERKUESI:** Perparim Ali Taullai i datelindjes 01.06.1948, lindur dhe banues ne Durres, Administrator i Shoqerise "IRI-TRANS" Sh.p.kDurres.

**OBJEKTI** : Depozitimin ne regjistrin tregetar te Vendimit Nr.1 date 08.09.2006 te Ortakut te vetem te Shoqerise "IRI-TRANS" Sh.p.k. Durres.

## GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR TIRANE

Shoqeria "IRI-TRANS" Sh.p.k eshte regjistruar si person juridik me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane nr. 34377 date 16.11.2005.

Duke iu referuar aktit te themelimit te kesaj shoqerie, statutit dhe vendimit te Gjykates se sipercituar Shoqeria "IRI-TRANS"shpk rezulton te kete kapital fillestar prej 100.000 leke.

Ortaku i vetem i kesaj shoqerie me vendimin nr. 1 date 08.09.2006 vendos te shese me kontrate para noterit 10% te kuotave te shoqerise "IRI-TRANS" shpk, Z. Rudin Taullai duke ndare ne masen sipas perqindejes se pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerise dhe detyrimet ndaj te treteve ne te ardhmen.

Gjothashtu ne kete vendim oratku i vetem i shoqerise ka vendosu dhe rritjen e objekti te aktivitetit te shoqerise"IRI-TRANS" me :BAR-RESTORANT(leja higj-sanitare nr 871 date 06.09.2006)

Per sa me lart per çka eshte vendosur me vendimin nr.1 date 08.09.2006 te ortakut te vetem te shoqerise "IRI-TRANS" Sh.p.k kerkoj nga Gjykata e rrethit gjyqesor Tirane te pranoje kerkesen per te bere ndryshimet perkatese ne regjistrin tregetar sipas kritereve ligjore.

Durres, 08.09.2006

KERKUESI
**Perparim Taullai**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
Notere Ines V.ALEKSI.
Nr. 1956 Rep Nr ___ Kol

## VERTETIM

Sot me date 08.09.2006(tete Shtator dymije e gjashte), ne Zyren e Noterise Durres u paraqit personalisht para meje noteres **Ines ALEKSI**, ortaku i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "IRI-TRANS" sh.p.k. z. Perparim TAULLAI, i biri i Ali i datelindjes 01.06.1948, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar nga pasaporta me nr. Z0042116 i cili nenshkroi para meje Noteres ***kerkesen per regjistrim te ndryshimeve sipas vendimit nr 1 te Asamblese se ortakeve te shoqerise" IRI-TRANS" te dates 08.09.2006 mbi shitjen e 10% te kuotave te shoqerise "IRI-TRANS"shpk Z. Rudin Taullai dhe shtese aktiviteti,*** dhe une noteri duke e gjetur ate te mbeshtetur ne ligj e vertetoj .

PULLE TAKSE

**NOTERE**
**Ines V.ALEKSI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE INES V. ALEKSI

**SHOQERIA ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"IRI-TRANS"sh.p.k**

# V E N D I M Nr. 1
## I ORTAKUT TE VETEM
## TE SHOQERISE"IRI-TRANS" sh.p.k.

Sot me date 08.09.2006 une, ortaku I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar **"IRI-TRANS"** sh.p.k ***Perparim TAULLAI***

**V E N D O S A:**

1. Ne baze te ligjes Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" Z.Perparim TAULLAI do t'i shese z.Rudin TAULLAI 10% (dhjete perqind ) te kuotave te kapitalit te shoqerise **"IRI-TRANS"** sh.p.k.

Shitja do te behet me kontrate shitje para Noterit, kontrate e cila do t'i bashkangjitet ketij vendimi.

2.Se bashku me shitjen e kuotave te kapitalit te shoqerise se shitur, Z.Rudin TAULLAI pranon marrjen persiper ne masen 10% te te gjitha detyrimet ligjore qe ka shoqeria, ne lidhje me te tretet dhe me organet shteterore ne ushtrimin e veprimtarise se saj.

3.Une Perparim TAULLAI me nenshkrimin e kontrates se shitjes behem ortak me Z Rudin TAULLAI ne masen 90% dhe 10% secili ne pronesine mbi shoqerine " IRI-TRANS" shpk.

4.Gjithashtu vendosa rritjen e aktivitetit te shoqerise"IRI-TRANS" duke shtuar ne vendimin e regjistrimit te personit juridik "IRI-TRANS" aktivitetin:**BAR-RESTORANT**

**ORTAKU I VETEM**
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**
**"IRI-TRANS" sh.p.k.**

**Z. Perparim TAULLAI**

Perparim Taullai

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE DURRES
Notere Ines V.ALEKSI.
Nr. 1954 Rep Nr 5811 Kol 1

***V E R T E T I M***

Sot me date 08.09.2006(tete Shtator dymije e gjashte), ne Zyren e Noterise Durres u paraqit personalisht para meje noteres **Ines ALEKSI**, ortaku i vetem i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "IRI-TRANS" sh.p.k. z. Perparim TAULLAI, i biri i Ali i datelindjes 01.06.1948, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, identifikuar nga pasaporta me nr. Z0042116 i cili nenshkroi para meje Noteres ***vendimin nr 1 te Asamblese se ortakeve te shoqerise" IRI-TRANS" te dates 08.09.2006 mbi shitjen e 10% te kuotave te shoqerise "IRI-TRANS"shpk Z. Rudin Taullai dhe shtese aktiviteti,*** dhe une noteri duke e gjetur ate te mbeshtetur ne ligj e vertetoj .

PULLE TAKSE
REPUBLIKA E SHQIPERISE INES V. ALEKSI NOTERE DURRES

**N O T E R E**

**Ines V.ALEKSI**

PULLE TAKSE
100 LEKE
R.SHQIPERISE

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE DURRES**
**Noter Ines ALEKSI.**
**Nr. 1955 Rep Nr. 582/1 Kol**

## KONTRATE SHITJE
## KUOTASH DHE KAPITALESH

Sot me date 08.09.2006, diten e premte,ne Zyren e Noterise Durres para meje noteres **Ines ALEKSI** me adrese Rruga "A Goga", u paraqiten personalisht palet:

**SHITESI:**

**Perparim TAULLAI** i biri i Ali i datelindjes 01.06.1948, lindur dhe banues ne Durres madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar identifkuar nga pasaporta me nr.Z00042116.

**BLERESI:**

**Rudin TAULLAI**, i biri i Perparim i datelindjes 2106.1975, lindur dhe banues ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i identifikuar me certifikate me foto nr 185/9-70 date 08.09.2006 .

**Te cilet kerkuan redaktimin e kontrates me permbajtjen e meposhteme :**

Me vendimin e Gjykates se Rrethit Tirane Nr.34377 date 16.11.2005 eshte regjistruar si person juridik, Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar"**IRI-TRANS**"shpk. **me ortak te vetem dhe Administrator te Pergjithshem Z.Perparim TAULLAI.** Duke u mbeshtetur ne veprimtarine e shoqerise ne Statutin dhe Kontraten e Themelimit une ortaku i vetem zoteroj ne emer te shoqerise 100% (njeqind perqind) te kapitalit fillestar dhe te kuotave ne shumen 100.000 ( njeqind mije ) lek.

Ne baze te Vendimit Nr.1 date 08.09.2006 te Ortakut te vetem te kesaj shoqerie, une Perparim Taullai i shes 10% te kapitalit fillestar ne shumen 10.000 ( dhjete mije ) lek dhe 10% te kuotave te kesaj shoqerie z. Rudin TAULLAI me vullnet te lire e te plote.

Z. Rudin Taullai eshte dakord per blerjen e kapitalit ne masen 10 % ne shumen 10.000 ( dhjete mije ) lek te shoqerise se mesiperme.

Se bashku me pranimin e kuotave te kapitalit te shoqerise te blere, ( 10 % ) Z. Rudin Taullai pranon te ndaje sipas perqindjes se pjesemarrjes ne kapitalin e kesaj shoqerie edhe te gjithe detyrimet ligjore qe ka shoqeria ne lidhje me te tretet dhe me organet shteterore.

Me nenshkrimin e kesaj kontrate shitje, shitesi Perparim TAULLAI behet bashkepronar me Z.Rudin Taullai mbi te drejten e pronesise mbi shoqerine dhe 10% te kapitalit i cili i kalon z. Rudin Taullai.

Kjo kontrate u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte ligjore dhe duke qene e bazuar ne ligj vertetohet prej meje noterit.

**SHITESI**
Perparim Taullai
Perparim Taullai

***NOTERE***
***Ines ALEKSI***

**BLERESI**
Rudin Taullai
Rudin Taullai

REPUBLIKA E SHQIPERISE INES V. ALEKSI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETSISË

Durrës më 06.8.2006
(rrethi)

Inspektoriati Sanitar Shtetëror Rrethi Durrës

NR.1304 Prot

Nr.2447 Mandati 0370

# LEJE HIGJENO – SANITARE Nr. 871

Në zbatim të Ligjit No. 7643, datë 02.12.1992 "Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror", neni 12, dhe Rregulloreve përkatëse higjeno sanitare, mbështetur në kërkesën e bërë nga Firma Tris Trans SHPK Përfaqësues Tauljai për objektin Bar-Restorante, me adresë (vendodhje të saktë) Ura Dajlanit Karavijes dhe vlerësimit të kontrollit higjeno – sanitar paraprak të bërë nga Inspektori Sanitar Shtetëror F. Kaleci, T. Cufi, me datë 20. 8. 2006

## VENDOSA:

Dhënie leje higjeno – sanitare për:

a. Sheshin e ndërtimit të Objektit ______
b. Projekt ndërtimor të objektit ______
c. Rikonstruksionit të objektit ______
d. Vënien në shfrytëzim të objektit Bar-Restorant

(të shënohet vetëm në rubrikën e kërkuar)
Leja higjeno – sanitare nuk lejohet të përdoret për destinacion tjetër. Çdo ndryshim që bëhet në projekt / objekt do të ripërsëritet Leja.
Kjo leje është e vlerfshmë për NJË VIT nga data e dhënies së saj. Zotëruesi i saj në mbarim të këtij afati është i detyruar të rifreskojë Lejen në Organet e Inspektoriatit Sanitar Shtetëror.

KRYEINSPEKTORI SANITAR SHTETËROR I RRETHIT

(Emër, mbiemër, firmë)

Dr. Shyqyri Beqja

K/INSPEKTOR SANITAR SHTETEROR DURRES SHYQYRI BEQJA

Inspektori Sanitar Shtetëror

Emër, mbiemër, firmë

Skender Lala

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE DURRES
NR. REP. 1953

## Vertetim I njesise se kopjes me origjinalin

Ne Durres, sot me daten [illegible]/2006(dymije e gjashte), diten e [illegible] para meje noteres se Dhomes se Notereve *Ines ALEKSI*, u paraqit personalishtZ./Znj. [illegible], lindur me 21/06/1975 banues ne [illegible], madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar identifikuar me [illegible]
i,e/cili/a paraqiti ne origjinal dhe fotokopje dokumentin
Akt Hapjen Sportele per "IRI-TRANS"

Fotokopja e ketyre dokumentave eshte e njejte me permbajtjen e origjinalit, nuk ka korrigjime, shtesa, fshirje ose shenje te vecanta.

Persa me siper une noterja , ne baze te ligjit 7829 date 01.06.1994"Per Noterine"I ndryshuar, neni 56,dhe udhezimit nr 6291 date 17.08.2005,te Ministrit te Drejtesise,vertetoj njesine me origjinalin.

**NOTERE**

***Ines ALEKSI***